“O Abas, o xhaxhai i të Dërguarit të Allahut, lute Allahun të të japë mirëqenie në këtë botë dhe në botën tjetër!

Abas ibn Abdulmutalibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton: Thashë: “O i Dërguari i Allahut, më mëso diçka që ta lus Allahun e Lartadhëruar!” Ai tha: “Kërkoji Allahut mirëqenie!” Pas disa ditësh shkova tek ai dhe i thashë: "O i Dërguari i Allahut, më mëso diçka që ta lus Allahun." Ai më tha: “O Abas, o xhaxhai i të Dërguarit të Allahut, lute Allahun të të japë mirëqenie në këtë botë dhe në botën tjetër!"
[Sahih li gajrihi] [Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ahmedi]

Xhaxhai i Profetit , Abasi ibn Abdulmutalibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i kërkoi Profetit t’i mësonte një dua që të mund t’i drejtohej Allahut me të, kështu që Profeti i mësoi atij të kërkonte nga Allahu mirëqenie dhe shpëtim nga sprovat dhe të metat, qoftë në fe, qoftë në këtë botë, qoftë në botën tjetër. Pas disa ditësh, Abasi u kthye përsëri te Profeti dhe i kërkoi që t’i mësonte një dua tjetër për t’iu lutur Allahut. Atëherë Profeti , me dashamirësi i tha: "O Abas, o xhaxhai i të Dërguarit të Allahut, kërko nga Allahu mirëqenie, që të të largojë çdo të keqe dhe të të sjellë çdo të mirë e dobi, qoftë në këtë botë, qoftë në botën tjetër!

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/2932